



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TE BRËNDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRËNDSHME DHE ANKESAT

Nr. 1325 Prot

Kopje 1 ;

Tiranë më 27.07/2020.

URDHËR

Nr. 63, datë, 27.07.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MARRËDHËNIET ME MEDIAN”

Në mbështetje të gërmës “a” të nenit 3, nenit 12 të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, nenit 7 të Rregullores së Shërbimit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 829, datë 03.12.2014, ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për marrëdhënien me mediat”.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik, në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.
3. Për kontrollin e zbatimit të këtij Urdhri ngarkohet Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së dhe Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Muhamet RRUMBULLAKU



RREGULLORE

PËR

MARRËDHËNIET ME MEDIAN

*Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit për Çështjet e Brendshme
dhe Ankesat*

Nr. 63 datë 27.07.2020

TABELA E PËRMBAJTJES

Kreu i parë	Dispozita të përgjithshme
Neni 1	Qëllimi
Neni 2	Objekti
Neni 3	Parimet e veprimtarisë
Neni 4	Përkufizime
Neni 5	Bashkëpunimi dhe komunikimi me median
Neni 6	Informacione përpara zhvillimit të seancave dëgjimore
Neni 7	Seancat dëgjimore
Neni 8	Informacione në lidhje me vendimet
Neni 9	Monitorimi i detyrimit për komunikimin me median

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe standardeve që do të zbatohen për bashkëpunimin dhe komunikimin me median, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së trupave vlerësuese.

Neni 2
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:
- a) rregullave dhe procedurave për bashkëpunimin dhe komunikimin me median gjatë procesit paraprak të vlerësimit të subjekteve;
 - b) rregullave dhe procedurave për bashkëpunimin dhe komunikimin me median gjatë seancave publike të vlerësimit të subjekteve;
 - c) rregullave dhe procedurave për bashkëpunimin dhe komunikimin me median gjatë procesit të dhënies së vendimeve për subjektet e vlerësimit.

Neni 3
Parimet e veprimtarisë

1. Gjatë veprimtarisë verifikuese dhe vlerësuese të subjekteve të vlerësimit sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, për bashkëpunimin dhe komunikimin me median, Shërbimi ndjek dhe respekton parimin e:
- a) transparencës;
 - b) të drejtës për informimin e publikut;
 - c) konfidencialitetit, ruajtjes së sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punonjës i SHÇBA-së” është personi i emëruar në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nëpunësve civilë.
2. “Punonjës policie” është personi i emëruar në Policinë e Shtetit, me gradë policore, në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit.
3. “Punonjës i Gardës së Republikës” është personi i emëruar në Gardën e Republikës, me gradë, në përputhje me ligjin për Gardën e Republikës së Shqipërisë.
4. “Subjekt vlerësimi” janë punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, si dhe ish-punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, pika 5, të ligjit 12/2018.

5. “Trupë vlerësimi” është njësi e vlerësimit e organizuar në formën e organit kolegjal përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj punonjësve që do të vlerësohen sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.

6. “Procesi i vlerësimit” përfshin si procesin kalimtar, ashtu dhe procesin periodik të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme.

7. “Partnerë ndërkombëtarë” janë organizatat ndërkombëtare dhe misionet e huaja që asistojnë Ministrinë e Brendshme, me të cilat organet e vlerësimit konsultohen gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të vlerësimit dhe vlerësimit kalimtar të punonjësve.

Neni 5

Bashkëpunimi dhe komunikimi me median

1. SHÇBA-ja synon informimin e gazetarëve në lidhje me bashkëpunimin, që ata mund të presin nga ana e SHÇBA-së.

2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, një person konsiderohet gazetar, nëse ai/ajo boton lajme në një media publikisht të aksesueshme.

3. Gazetari, i cili dëshiron të përdorë mjediset për mediat, duhet të paraqesë kartën e shtypit. Gazetari, i cili nuk e ka këtë kartë, është i detyruar të nënshkruajë protokollin për mediat. SHÇBA do t’u kërkojë mediave vendase akreditimin e punonjësve të tyre, të cilët do të vizitojnë rregullisht mjediset e SHÇBA-së.

4. Shërbimi nëpërmjet koordinorit, shpërndan informacion, në interes të një procesi vlerësimi sa më të hapur, transparent dhe në përputhje me ligjin.

5. Komunikimi mund të kryhet çdo ditë pune në periudhën 09:00 deri në orën 16:30, nëpërmjet telefonit apo e-mail.

6. Informacionet mbi çështjet e përgjithshme lidhur me procesin e vlerësimit, do të jepen nëpërmjet faqes së internetit të SHÇBA -së.

7. Kërkesat për informacione lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit duhet t’i drejtohen dhe do të koordinohen nga koordinatori për mediat nëpërmjet rrugës elektronike apo postës zyrtare.

8. SHÇBA do të publikojë informacione të përgjithshme dhe të përditësuara në lidhje me procesin e vlerësimit në faqen zyrtare të Web-it.

9. Të dhënat e kontaktit për koordinatorin për mediat në SHÇBA mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit.

10. Në bazë të ligjit, SHÇBA mund të vendosë rregulla (shtesë) me qëllim ruajtjen e rendit në selinë e institucionit dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

Neni 6

Informacione përpara zhvillimit të seancave dëgjimore

1. Koordinatori për mediat në SHÇBA do t'u ofrojë mediave informacione teknike për seancat dëgjimore që po zhvillohen, si dhe për ato në vijim. Të gjitha komunikimet me jashtë kryhen nën përgjegjësinë e titullarit të institucionit.

2. Informacioni mbi seancat dëgjimore mund të merret jo më herët se një javë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore përkatëse. Ato do të bëhen publike në faqen zyrtare të SHÇBA-së.

3. Nëse mediat e dinë datën e zhvillimit të një seance të caktuar, koordinatori për mediat mund t'u japë atyre informacione mbi çështje faktike që kanë lidhje me këtë seancë.

4. Dokumentet procedurale, pjesë e dosjes së vlerësimit, nuk vihen në dispozicion për njohje dhe nuk publikohen. Një gjë e tillë ndalohej me ligj. Këto dokumente mund të njihen vetëm nga pala ose palët në proces dhe nga zyrtarët e institucioneve përkatëse të vlerësimit.

Neni 7

Seanca dëgjimore

1. Seancat dëgjimore të SHÇBA-së janë publike dhe mund të ndiqen nga gazetarët.

2. Gazetarëve u lejohej të dërgojnë mesazhe në format teksti nga celularët e tyre gjatë zhvillimit të seancës. Zëri në këto aparate duhet të jetë i fikur.

3. Kryesuesi i trupës vlerësuese mund ta kufizojë apo ta ndalojë një komunikim të tillë, nëse ai do të pengonte hetimin apo zhvillimin e rregullt të procesit të seancës.

4. Gazetarët që duan të bëjnë regjistrime me zë (apo edhe me figurë), duhet që më parë të kërkojnë leje nga koordinatori për mediat, i cili mund të vendosë kushte për dhënien e lejes nga ana e SHÇBA-së.

5. Gazetarëve u jepet mundësia të bëjnë fotografi përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, në një moment të rënë dakord me koordinatorin për mediat.

6. Me qëllim zhvillimin e rregullt të seancës dëgjimore, regjistrimet pamore lejohen vetëm nga një pozicion fiks në sallën e seancës, që do të përcaktohet nga koordinatori për mediat ose pas konsultimit me të.

7. Me qëllim zhvillimin e rregullt të seancës dëgjimore, kryesuesi i trupës së vlerësimit mund të vendosë që t'i lejohej hyrja në sallën e seancës vetëm një numri të kufizuar grupesh regjistrimi me kamera. SHÇBA mund të vendosë si kusht që ato media, të cilave u lejohej të regjistrojnë, duhet të shpërndajnë menjëherë regjistrimet edhe te mediat e tjera.

8. Nëse u jepet leje nga ana e SHÇBA-së dhe kur t'u jepet kjo leje, gazetarëve u lejohej të bëjnë regjistrime (pamore) të hyrjes zyrtare të trupës në sallën e zhvillimit të seancës dëgjimore dhe në çeljen e seancës dëgjimore nga ana e kryesuesit të trupës së vlerësimit. Më pas fiken kamerat dhe mikrofonat dhe këto mjete hiqen nga salla e zhvillimit të seancës.

9. Mund të regjistrohen vetëm pjesëmarrësit profesionistë në seancë dëgjimore. Nuk lejohet të regjistrohen as me zë dhe as me figurë subjekti i vlerësimit, përfaqësuesi i tij, dëshmitarët, publiku, si dhe asnjë pjesëmarrës jo profesionist në seancë.

10. Me përjashtim të regjistrimeve të parashikuara në pikat 6,7,8 të këtij neni nuk lejohet të kryhen regjistrime të tjera me zë apo me figurë në mjediset e institucionit.

11. Seancat dëgjimore konsiderohen si seanca administrative pak a shumë “të zakonshme”.

12. Mediat e shkruara janë vazhdimisht të pranishme në seancat gjyqësore. Prania e tyre nuk duhet të ketë asnjë ndikim mbi procesin e vlerësimit.

13. Mesazhet me shkrim që dërgohen nga ana e këtyre gazetarëve kur ndodhen në sallën e zhvillimit të seancës dëgjimore nuk përbëjnë asnjë ndërhyrje në zhvillimin e rregullt të ngjarjeve në seancë.

14. Stafit i mediave mund të raportojë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi proceset që janë duke u zhvilluar, duke postuar mesazhe të shkurtra me shkrim në faqen e internetit të medias së tyre.

15. Nëpërmjet internetit, publiku mund të ndjekë thujtë në kohë reale ecurinë e ngjarjeve në seancat dëgjimore.

16. Në këto udhëzime janë përcaktuar rregulla specifike për regjistrimet me zë apo me figurë gjatë seancave dëgjimore. Personat që marrin pjesë në seanca dëgjimore, apo ata që janë të pranishëm në to për arsye të tjera, qoftë subjekti i vlerësimit dhe përfaqësuesi i tij/saj, apo pjesëmarrës nga publiku, duhet të ndihen të lirshëm për të marrë pjesë plotësisht dhe me vullnet të lirë, apo edhe të jenë të pranishëm.

17. Regjistrimet e miratuara të seancës dëgjimore duhet të bëhen nga një kënd i caktuar, në mënyrë që kamera të ndërhyjë sa më pak që të jetë e mundur. Me qëllim që të arrijë të kryejë parapërgatitjet e nevojshme, SHÇBA u kërkon mediave që kërkesa për regjistrim të bëhet të paktën 72 orë përpara seancës dëgjimore.

18. Kryesuesi i trupës vlerësuese është përgjegjës për ecurinë e saktë të ngjarjeve gjatë seancës dëgjimore. Për këtë qëllim, ai ose ajo mund të kufizojë masën në të cilën mediave audiovizuale u jepet e drejta e ndjekjes së mbledhjeve.

Neni 8

Informacione në lidhje me vendimet

1. Mediave u lejohet të filmojnë shpalljen publike të vendimit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim do të publikohet në faqen zyrtare të SHÇBA-së.
3. Në parim, të gjitha vendimet do të shpallen publikisht në njërin prej sallave të zhvillimit të seancave dëgjimore,
4. Në përputhje me dispozitat e pikës 3, sa më sipër, duhet të bëhet kërkesë për regjistrim gjatë seancës për shpalljen e vendimit me zë dhe me figurë.

Neni 9

Respektimi i këtyre udhëzimeve

1. SHÇBA do të monitorojë respektimin rigoroz të udhëzimeve në lidhje me mediat.

2. SHÇBA mund të marrë masat e nevojshme ndaj (stafit të) mediave, që nuk respektojnë udhëzimet e tij mbi mediat. Gjatë marrjes së këtyre masave, SHÇBA do të marrë parasysh llojin dhe shkallën e shkeljes.